UDHËZIM
Nr. 5, datë 17.2.2023

PËR ZHVILLIMIN E PROVIMEVE KOMBËTARE TË ARSIMIT BAZË, NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, VITI SHKOLLOR 2022-2023 (SESIONI I PARË)

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të neneve 26 dhe 50, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Provimet kombëtare të arsimit bazë për vitin shkollor 2022-2023 (sesioni i parë) do të zhvillohen në datat si më poshtë:

a) Lënda "Gjuhë shqipe", 20 qershor 2023.

b) Lënda "Matematikë", më 23 qershor 2023.

c) Lënda "Gjuhë e huaj" e parë, më 26 qershor 2023.

2. Nxënësit e pakicave kombëtare zhvillojnë edhe provimin kombëtar të arsimit bazë në lëndën "Gjuhë amtare". Provimi kombëtar i arsimit bazë në lëndën "Gjuhë amtare", do të zhvillohet më datë 21 qershor 2023.

3. Procedurat e hartimit dhe vlerësimit të testeve përcaktohen në *rregulloren për zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë në Republikën e Shqipërisë,* miratuar me Urdhrin nr. 72, datë 25.2.2020, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, "Për miratimin e rregullores për zhvillimin e provimeve kombëtare të arsimit bazë, në Republikën e Shqipërisë".

4. Gjuhët e huaja që do të jepen si provim i detyruar, janë: "Anglisht", "Frëngjisht", "Italisht" dhe "Gjermanisht". Testi i gjuhës së huaj të parë hartohet në përputhje me gjuhën e cila, në planin mësimor të arsimit të mesëm të ulët, trajtohet si gjuhë e huaj e detyruar në nivelin gjuhësor A2.

5. Nxënësit e klasave të 9-ta të shkollave mbështetëse të seksioneve dygjuhëshe franceze, italiane dhe gjermane japin provim gjuhën përkatëse të seksionit në nivelin gjuhësor A2.

6. Çdo provim kombëtar i arsimit bazë fillon në orën 10:00 dhe zgjat 2 orë e 30 minuta.

7. Për hartimin e testit në lëndën "Gjuhë amtare" të pakicës kombëtare greke, ndiqet procedura si vijon:

a) Testi, përgatitet nga një grup pune me 3 (tre) mësues dhe 1 (një) pedagog, të ngritur me urdhër të drejtorit të Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP) Fier.

b) Mësuesit dhe pedagogu që hartojnë testin propozohen nga zyrat vendore të arsimit parauniversitar përkatësisht: Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar (ZVAP) Finiq-Dropull, ZVAP Gjirokastër-Libohovë, ZVAP Sarandë-Konispol-Delvinë dhe ZVAP Vlorë-Himarë.

c) Grupi i punës që përgatit testin mblidhet në ZVAP Finiq-Dropull.

d) Testi tërhiqet në ZVAP Finiq-Dropull.

e) Përfaqësuesit e ZVAP Gjirokastër-Libohovë, ZVAP Sarandë-Konispol-Delvinë dhe ZVAP Vlorë-Himarë e tërheqin testin në ZVAP Finiq-Dropull, një ditë para provimit, ndërsa ata të ZVAP Finiq-Dropull e tërheqin testit në ditën e provimit.

8. Për hartimin e testit në lëndën "Gjuhë amtare" të pakicës kombëtare maqedonase, ndiqet procedura si vijon:

a) Testi, përgatitet nga një grup pune me 3 (tre) mësues dhe 1 (një) pedagog, të ngritur me urdhër të drejtorit të DRAP-së Korçë.

b) Grupi i punës që përgatit testin mblidhet në DRAP Korçë.

c) Testi tërhiqet në DRAP Korçë.

d) Përfaqësuesit e ZVAP Korçë-Pustec e tërheqin testin në ditën e provimit.

9. Nxënësit me aftësi të kufizuara që ndjekin shkollat e zakonshme, i zhvillojnë provimet kombëtare të arsimit bazë, mbështetur në planin edukativ individual me të cilin punojnë në përshtatje me veçoritë e tyre.

10. Drejtuesi i institutit të nxënësve që nuk shikojnë "Ramazan Kabashi", e tërheq testin në Qendrën e Shërbimeve Arsimore (QSHA), një ditë para zhvillimit të provimit dhe e kthen atë në sistemin e shkrimit Brail.

11. Sektori i Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional në ZVAP-në përkatëse, merr nga qendrat e vlerësimit të testeve dhe ruan të dhënat e çdo nxënësi, të vlerësuesve të testeve dhe të mjediseve ku janë realizuar provimet kombëtare të arsimit bazë. Këto të dhëna dërgohen nëpërmjet DRAP-së në QShA dhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar.

12. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit për Arsimin dhe Sportin, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia për Sigurimin e Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Evis Kushi